



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA


KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

(01 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025)

KY RAPORT PASQYRON PUNËN E DREJTORISË PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM



Deçan, 2026

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim gjatë vitit 2025 ka realizuar aktivitete të mëposhtme:

Gjatë këtij viti 2025, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, në përputhje me fushën e saj të veprimtarisë, ka ofruar punë dhe shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës së Deçanit. Këto veprimtari janë zhvilluar në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet nënligjore, rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal në Deçanit, si dhe dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2025. Punët dhe shërbimet e Drejtorisë kanë përfshirë hartimin dhe realizimin e politikave zhvillimore, marrjen e masave për të nxitur zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit, si dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për një zhvillim sa më të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

1. Hartimin e politikave të zhvillimit ekonomik për Komunën.
2. Bashkëpunimin me organet e tjera komunale për informim rreth planeve zhvillimore.
3. Kryerjen e analizave që shërbejnë si bazë për planet zhvillimore.
4. Caktimin dhe propozimin e prioriteteve të zhvillimit në fusha të ndryshme, veçanërisht në fushën e turizmit.
5. Organizimin e ekipeve të ekspertëve të ndryshëm për hartimin e planit të zhvillimit ekonomik në nivel komunal dhe për hartimin e projekteve kapitale për të përfituar donacione.
6. Hartimin e strategjisë së zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë të Komunës.
7. Bashkëpunimin me organet relevante në nivelin lokal dhe qendror.
8. Bashkëpunimin me ekspertë të fushave të ndryshme për të përfituar nga përvojat dhe njohuritë e tyre në zhvillim.
9. Dhënien e këshillave me interes për ekonominë private-reale.
10. Pjesëmarrjen në seminare dhe promovime me karakter zhvillimor.
11. Kryerjen e detyrave të tjera në fushën e zhvillimit ekonomik.

Këto përpjekje të drejtorisë kanë qenë të fokusuara në përmirësimin e klimës së të bërit biznes, promovimin e Komunës së Deçanit si një destinacion atraktiv për investitorët dhe turistët, si dhe në mbështetjen e ideve inovative dhe projekteve të reja, duke ofruar gjithmonë shërbime dhe konsulenca profesionale.

Aktivitetet e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në vitin 2025

Përmbledhje e mbarëvajtjes dhe ecurisë së punës

Në vitin 2025, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka angazhuar resurset e saj për të mbështetur dhe lehtësuar zhvillimin e sektorit të biznesit në Komunën e Deçanit, me synimin për të krijuar një mjedis më të mirë për sipërmarrësit dhe për të nxitur rritjen ekonomike. Aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

1. Regjistrimi i bizneseve fillestare, duke përfshirë bizneset individuale, shoqëritë aksionare, ortakëritë e përgjithshme dhe të kufizuara, shoqëritë e huaja tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore.
2. Procesimi i ndryshimeve në të dhënat e bizneseve ekzistuese.
3. Pajisja e bizneseve me çertifikata të reja me Numër Unifikues të Identifikimit (NUB), si një masë për të rritur transparencën dhe efikasitetin në menaxhimin e bizneseve.
4. Dhënia e informacioneve shtesë dhe udhëzuese për bizneset, për të ndihmuar në navigimin e tyre nëpër proceset ligjore dhe rregullatore.
5. Protokollimi i të gjitha çështjeve ligjore dhe administrative që lidhen me bizneset, duke siguruar një menaxhim të qartë dhe të dokumentuar të këtyre çështjeve.
6. Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve të rregullta, javore dhe mujore, tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), për të siguruar një linjë të qartë komunikimi dhe raportimi.
7. Lëshimi i vërtetimeve për individët që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore, duke u mundësuar atyre të vërtetojnë statusin e tyre si jobiznismenë.
8. Sigurimi i vërtetimeve për bizneset që nuk kanë borxhe apo obligime ndaj taksave komunale, duke i ndihmuar ato të vazhdojnë operacionet e tyre pa pengesa ligjore.
9. Shqyrtimi dhe trajtimi i kërkesave, ankesave dhe çështjeve të tjera që vijnë nga bizneset, duke ofruar zgjidhje dhe këshilla profesionale.
10. Përcaktimi dhe zbatimi i taksave komunale për bizneset, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e vendosura.
11. Ofrimi i konsulencave dhe ndihmës së specializuar për bizneset, për të nxitur zhvillimin dhe zgjerimin e tyre.
12. Angazhimi dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme, duke kontribuar në vendimmarrje dhe politika zhvillimore që prekin sektorin e biznesit.

Me këto veprime, Drejtoria ka synuar të forcojë mjedisin e biznesit në komunë, të nxisë krijimin e vendeve të reja të punës dhe të përmirësojë klimën ekonomike përgjithësisht,

duke vënë theksin në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Statistikat e Regjistrimit dhe Shërbimeve të Bizneseve nga Zyra për Biznese 2025

Gjatë këtij vitit 2025, Zyra për Biznese në Komunën e Deçanit ka regjistruar një rritje të konsiderueshme në numrin e bizneseve të reja. Nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, janë regjistruar gjithsej 101 biznese të reja. Këto biznese, sipas deklaratave të tyre, kanë punësuar 192 punonjës, duke kontribuar në rritjen e punësimit në komunë. Për të lehtësuar procesin e regjistrimit dhe për të ofruar një mjedis të përshtatshëm për sipërmarrësit, bizneset fillestare janë pajisur brenda ditës me çertifikatën e biznesit që përmban Numrin Unik të Identifikimit të Biznesit. Poashtu, janë ofruar konsulenca të ndryshme për të ndihmuar bizneset në të gjitha ndryshimet e nevojshme ligjore dhe administrative.

Detajet mbi numrin e bizneseve të regjistruara në bazë të llojit të pronësisë janë si më poshtë:

- **Biznes Individual:** 22
- **Ortakëri e Përgjithshme:** 0
- **Ortakëri e Kufizuar:** 0
- **Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar:** 79
- **Shoqëri Aksionare:** 0
- **Ndërmarrje në Pronësi të Huaj:** 1
- **Ndërmarrje Publike:** 0
- **Kooperativë Bujqësore:** 0
- **Totali:** 101

Përveç regjistrimit të bizneseve të reja, Zyra për Biznese ka trajtuar edhe një numër të kërkesave dhe ndryshimeve në bizneset ekzistuese. Detajet e shërbimeve dhe kërkesave janë si vijon:

1. **Shuarje të Bizneseve:** 17
2. **Kërkesë për Shtimin apo Heqjen e Aktivitetit:** 51

3. **Kërkesë për Informata: 92**
4. **Kërkesë për Shtim apo Ndryshim të Njesisë: 47**
5. **Kërkesë për Ndryshim të Adresës: 12**
6. **Kërkesë për Ndryshimin e Drejtorit apo Përfaqësuesit të Autorizuar: 31**
7. **Kërkesë për Certifikatë Dublikat: 9**
8. **Kërkesë për Ndryshim Emrit Tregtar: 0**
9. **Kërkesë për Ndryshim të Kapitalit: 0**
10. **Kërkesë për Ndryshimin e Pronarëve/Aksionarëve: 28**
11. **Çertifikata të Reja për Biznese Fillestare: 101**
12. **Çertifikata të Ripërtërira me Numër Unik: 0**
13. **Vërtetime për Persona Fizik që nuk Ushtrojnë Veprimtari Jo-Biznesore: 8**
14. **Vërtetime për Persona Fizik që nuk Ushtrojnë Veprimtari Biznesore: 14**

Këto statistika dhe aktivitete dëshmojnë angazhimin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në mbështetjen e sipërmarrjes dhe në rritjen e ekosistemit të biznesit në Komunën e Deçanit. Përpjekjet e vazhdueshme për të ofruar shërbime efikase dhe të përshtatshme bizneseve kontribuojnë në një mjedis më të mirë për zhvillimin ekonomik të komunës.

➤ **Aktivitetet e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në vitin 2025**

Gjatë vitit 2025, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Deçanit angazhoi një sërë iniciativash me synimin për të forcuar zhvillimin ekonomik dhe social në rajon. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- **Takime strategjike:** U organizuan takime me përfaqësues të institucioneve qendrore, organizatave vendore dhe ndërkombëtare për të arritur marrëveshje dhe bashkëpunime. Qëllimi ishte të sigurohet mbështetje dhe financim për projekte zhvillimore që do të kontribuojnë në rritjen ekonomike të Komunës së Deçanit dhe të sektorit privat.
- Pjesëmarrje në tryezën diskutuese për Taksën e Akomodimit, organizuar nga Swisscontact – Projekti "Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat" (PPSE) dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës.
- U organizuan takime me përfaqësues të institucioneve qendrore, organizatave vendore dhe ndërkombëtare për të arritur marrëveshje dhe bashkëpunime. Qëllimi ishte të sigurohej mbështetje dhe financim për projekte zhvillimore që do

të kontribuojnë në rritjen ekonomike të Komunës së Deçanit dhe të sektorit privat.	
	○ Takim i Kolegjiumit për Zhvillim Ekonomik (Asociacioni i Komunave të Kosovës) ○ Me kërkesë të Rektorit, Prof. Dr. Armand Krasniqi, pjesëmarrje në takimin e parë koordinues për implementimin e aktiviteteve të bazuara në memorandume bashkëpunimi ndërmjet komunave, universitetit dhe forumit ekonomik rajonal Dukagjini (FERD). ○ Marrëveshje mirëkuptimi midis Komunës së Deçanit dhe CDF. ○ Memorandum bashkëpunimi me Swisscontact për çertifikimin dhe trajnimin e stafit për Via Ferrata.
- Trajnime dhe panele edukative:	Drejtoria është përfshirë në disa programe trajnimesh dhe panele edukative për të rritur kapacitetet e stafit dhe për të përmirësuar menaxhimin e projekteve.
	○ Trajnim Online "Hartimi dhe Menaxhimi i Projekteve" sipas formatit të BE-së, organizuar nga TBD Consulting (2 javë). ○ Trajnimet 2-ditore me temën "Menaxhimi i Qëndrueshëm i Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore" të projektit "Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë - "TIME TRAVEL", organizuar në fshatin Belle. ○ Trajnime për personelin që punon në atraksione turistike në kursin "Menaxher i Sigurisë për Kurse në Litar" (ERCA Ropes Course Safety Manager), të mbajtur më 26, 27 dhe 28 qershor në Hotel Dukagjini, Pejë.
- Dialogu me bizneset:	U zhvilluan takime me përfaqësues të bizneseve për të diskutuar sfidat, pengesat dhe mundësitë e zhvillimit, si dhe për të hartuar plane strategjike zhvillimore.
	○ Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) në koordinim me drejtorë të Zhvillimit Ekonomik mbajti takim për shpalljen e Grant Skemës "Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar" 2025, për mbështetjen e bizneseve ekzistuese dhe ndërmarrësve të rinj me start-up biznese.
- Vizita në komuna të tjera:	Drejtoria zhvilloi vizita në komunat e Ulqinit, Gjakovës, Klinës, Pejës dhe Lezhës, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet drejtorive komunale për të ndarë praktikat më të mira dhe për të nxitur inovacionin.
- Promovimi i projekteve dhe eventeve zhvillimore:	Drejtoria mori pjesë në disa evente dhe panairë për të promovuar Komunën e Deçanit dhe për të tërhequr investime të reja.
	○ Pjesëmarrës në Panairin e Turizmit dhe Karrierës i organizuar nga Universiteti "Haxhi Zeka", Oda e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës dhe Forumi Ekonomik Rajonal Dukagjin.

○ Pjesëmarrës si komunë në edicionin e 21-të të Panairit të Turizmit dhe Sportit për dy ditë rresht si Visit Deçani. ○ Vizita dhe promovimi i Panairit Veror në biznese të ndryshme në Durrës.
- Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar: Drejtoria bashkëpunoi me institucione rajonale dhe organizata ndërkombëtare për të përfituar nga praktikat më të mira dhe për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.
○ Pjesëmarrje dhe fitues i njërit nga shpërblimet në kuadër të ndarjes së çmimeve të "Tourism Grand Excellence – Edicioni II". ○ Bashkëpunimi me Shoqatat dhe OJQ-të: U mbajtën takime me përfaqësues të shoqatave dhe organizatave joqeveritare për të koordinuar aktivitete që do të ndikojnë pozitivisht në jetën ekonomike dhe sociale në nivel lokal. ○ Asociacioni Kosovar për Energji të Ripërtëritshme dhe Eficiencë të Energjisë (AKEREE) realizoi projektin "Rritja e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike në nivel lokal", duke organizuar punëtorinë e dytë me temën "Ndikimi i ndryshimeve klimatike në biodiversitet dhe masat e përshtatjes në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë – përmbytjet dhe erozioni". ○ Pjesëmarrës në lansimin e projektit "Mountainscape", zbatuar nga organizatat CHwB Kosova dhe GO2 Albania, mbështetur nga Zyra Rajonale e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor në Tiranë.
- Vizita në bizneset prodhuese: Drejtoria vizitoi biznese prodhuese për të marrë njohuri të drejtpërdrejta mbi problemet, sfidat dhe mundësitë e ndihmës nga autoritetet lokale. - Hulumtime dhe studime: Drejtoria u përfshi në hulumtime dhe studime për të vlerësuar efektivitetin e planifikimit strategjik dhe për të siguruar furnizimin me ujë në zonat rurale.
○ Hulumtim mbi Efikasitetin e Planifikimit Strategjik në Institucionet e Sektorit Publik të Kosovës – pjesëmarrës në takim. ○ Pjesëmarrës në prezantimin e Përmbledhjes së Politikave "Siguria e furnizimit me ujë në Zonat Rurale".
- Vizita studimore: Drejtoria zhvilloi një vizitë studimore në qytetin e Gjirokastrës për dy ditë, me fokus në agroturizëm.
- Dialogu me bizneset: U zhvilluan takime me përfaqësues të bizneseve për të diskutuar sfidat, pengesat dhe mundësitë e zhvillimit, si dhe për të hartuar plane strategjike zhvillimore. - Vizita në komuna të tjera: Drejtoria zhvilloi vizita në Komunat e Ulqinit, Gjakovës, Klinës, Pejës dhe Lezhës, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit

ndërmjet drejtorive komunale për të ndarë praktikat më të mira dhe të nxisin inovacionin.

- **Bashkëpunimi rajonal:** U zhvillua një takim me kryetarin e Ulqinit për të diskutuar organizimin e eventeve të përbashkëta, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal.
- **Vizita dhe promovimi i Panairit Veror:** U zhvilluan vizita në biznese të ndryshme në Durrës, me qëllim të promovimit të Panairit Veror në Komunën e Deçanit.
- **Bashkëpunimi me Shoqatat dhe OJQ-të:** U mbajtën takime me përfaqësues të shoqatave dhe organizatave joqeveritare për të koordinuar aktivitete që do të ndikojnë pozitivisht në jetën ekonomike dhe sociale në nivel lokal.
- **Vizita në bizneset prodhuese:** Drejtoria vizitoi biznese prodhuese për të marrë njohuri të drejtpërdrejta mbi problemet, sfidat dhe mundësitë e ndihmës nga autoritetet lokale.
- **Pjesëmarrja në Panairin e Lezhës:** Drejtoria ishte pjesëmarrëse aktive në organizimin e Panairit të Lezhës në Prishtinë, duke promovuar kështu produktet dhe shërbimet lokale.
- **Ftesa për aplikime për subvencionim:** U bë thirrje për aplikim për subvencionim me mjete financiare për NVMV, të lansuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), duke nxitur kështu sipërmarrjen në komunë.
- **Bashkëpunimi Ndërkombëtar:** U zhvillua një takim me përfaqësues të Agjencisë Italiane dhe organizatës Celim për të diskutuar mbi projektin "NaturKosovo" dhe fazat e vijueshme të projektit, duke synuar të nxisë turizmin dhe ruajtjen e mjedisit.
- **Thirrja për propozime:** U bë një thirrje për propozime në Programin për Zhvillim Rajonal për Investime Kapitale nga Zyrat e Agjencisë për Zhvillim Rajonal, duke inkurajuar projektet që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm rajonal.
- **Krijimi i Grupit Punues:** U formua grupi i anëtarëve në Grupet Punuese Rajonale për promovimin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore në AZHR Perëndimi, duke synuar të rrisë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet komunave.
- **Punësoria për Bashkëpunimin Ndërkomunal:** Drejtoria mori pjesë në punëtorinë me temën "Bashkëpunimi Ndërkomunal" të organizuar nga Instituti Kosovar për Qeveri Lokale, duke diskutuar mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet komunave në projekte të përbashkëta.
- **Draft strategjia e turizmit:** U zhvillua draft strategjia e turizmit në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për të përcaktuar drejtimet e reja të zhvillimit turistik në komunë.

- **Promovimi i Turizmit Malor:** U krijua lista e shtëpive akomoduese në Bjeshkët e Nemuna përmes organizatës Swisscontact në Kosovë, duke promovuar turizmin malor dhe traditat lokale.
- **Krijimi i Shtigjeve të Çiklizmit:** U ndërmor iniciativa për krijimin e katër shtigjeve të çiklizmit në zonën e Komunës së Deçanit, duke ofruar mundësi të reja për rekreacion dhe turizëm aktiv.
- **Pjesëmarrja në lansimin e publikimit "Shijet e Dukagjinit"** nga CHwB Kosova, një iniciativë që promovon trashëgiminë kulturore dhe gastronomike të rajonit.
- **Pjesëmarrje dhe fitues i njërit nga shpërblimet në kuadër të ndarjes së çmimeve të "Tourism Grand Excellence – Edicioni II".**
- **Bashkëpunimi me Swiss Contact dhe AZHR-Perëndim:** U zhvillua një bashkëpunim në kuadër të projektit PPSE për promovimin e punësimit në sektorin privat.
- **Dëgjim Publik për Projektligjin e Turizmit:** Pjesëmarrje në dëgjim publik të organizuar nga Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, duke kontribuar në politikat e turizmit.
- **Krijimi i Listës së Akomodimeve Turistike:** U hartua një listë e hoteleve, restoranteve dhe resorteve në Deçan, si dhe u përditësuan të dhënat për sektorin e turizmit dhe hotelerisë, duke përfshirë sfidat dhe nevojat për menaxhimin e turizmit të qëndrueshëm.
- **Bashkëpunimi për promovimin e turizmit:** U bashkëpunua me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për të promovuar turizmin në Deçan.
- **Pjesëmarrja në Konferencën e Donatorëve 2025:** Propozimi i projekteve nga Komuna e Deçanit në këtë konferencë të rëndësishme.
- **Punëtorja për Zhvillimin Ekonomik Lokal:** Pjesëmarrje në punëtorinë me temën "Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030", e organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale.
- **Bashkëpunimi me Jakova Innovation Center:** Takim për të diskutuar projekte që synojnë fuqizimin e të rinjve, grave dhe grupeve të pafavorizuara.
- **Diskutime me Swisscontact:** Takime për të diskutuar mbi projektet e turizmit në Komunën e Deçanit.
- **Vizita në biznese:** Vizita në biznese të ndryshme të Komunës së Deçanit për të marrë informacione nga afër mbi sfidat dhe mundësitë e bizneseve lokale.
- **Pjesëmarrja në Panairin e Deçanit:** Organizimi dhe pjesëmarrja në Panairin e IAAP "Tafil Kasumaj" në Deçan në vitin 2025.
- **Vizita në biznese prodhuese:** Vizita në biznese që eksportojnë produkte jashtë Kosovës për të kuptuar më mirë nevojat dhe sfidat e tyre.
- **Themelimi i Shoqatës së Miqësisë Kosovë-Austri:** Pjesëmarrja në eventin e themelimit, ku u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit për zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit.

- **Trajnimet e Asociacionit të Komunave të Kosovës:** Pjesëmarrje në trajnimin "Komunat Gjithëpërfshirëse", duke theksuar rëndësinë e përfshirjes dhe bashkëpunimit ndërmjet komunave.
- **Punëtorja për Zhvillimin e Qëndrueshëm:** Pjesëmarrje në punëtori për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rajonal përmes projekteve për investime kapitale, në bashkëpunim me Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe UN-Habitat Kosovë.
- **Aplikimi në Fondet Europiane IPA:** Pjesëmarrje në thirrjen për bashkëpunim ndërkufitar Kosovë-Shqipëri në kuadër të programit IPA.
- **Trajnimet e CNASAS:** Pjesëmarrje në trajnimet e CNASAS në zonën e Bjeshkëve të Nemuna, përfaqësuar nga Zyra e Turizmit dhe anëtarë të tjerë.
- **Takimi me Kolegjin për Zhvillim Ekonomik Lokal:** Pjesëmarrje në takimin me z. Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv i AKK-së, për të diskutuar mbi zhvillimin lokal.
- **Trajnim për pjesëmarrjen në Programet IPA:** Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale mbi pjesëmarrjen e komunave në programet IPA.
- **Tryeza për bashkëpunimin në turizëm:** Pjesëmarrje në tryezën e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për koordinimin dhe bashkëpunimin në fushën e turizmit.
- **Bashkëpunimi Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë:** Pjesëmarrje në programin IPA për bashkëpunimin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës, veçanërisht në rajonin e Rahovecit.
- **Takim me Departamentin e Investimeve:** Diskutime me përfaqësues nga Departamenti i Investimeve në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- **Përpilimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal:** Krijimi i grupit punues për zhvillimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Deçanit.
- **Projekti për ZipLine në Deçan:** Formimi i ekipit dhe projektimi i një atraksioni turistik - ZipLine në Deçan.
- **Harmonizimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal:** Pjesëmarrje në punëtorinë për harmonizimin e strategjive për zhvillim ekonomik lokal me agjendat për zhvillim të qëndrueshëm.
- **Nënshkrimi i Memorandumit për Trashëgiminë Kulturore:** Pjesëmarrje në organizimin e nënshkrimit të memorandumit për Brendin Rajonal të Trashëgimisë Kulturore nga CHwB dhe 6 komunat rajonale.
- **Sfidat në Legjislacionin Komunal:** Pjesëmarrje në punëtorinë për sfidat e implementimit të legjislacionit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale.

- **Grantet për Mikro-Bizneset:** Drejtoria ndihmoi në orientimin e granteve drejt mikro-bizneseve, shoqatave dhe fermerëve të lidhur ngushtë me projektin Via Dinarica.
- **Fizibiliteti i shtigjeve në kuadër të #NaturKosovo:** U krye studimi i fizibilitetit të shtigjeve në bjeshkët e Deçanit si pjesë e shtegut të Via Dinarica, duke përfshirë edhe zgjerimin e tyre për të përmirësuar aksesin dhe përvojën turistike.
- **Sesioni Trajnues për Mikro Shërbimet:** Gjatë muajit Korrik, u mbajt një sesion trajnues për të gjithë ofruesit e mikro shërbimeve në Deçan të interesuar për të aplikuar për mini-grante nga "Volontari nel Mondo RTM" Kosovo në kuadër të projektit "NaturKosovo".
- **Promovimi i turizmit:** U zhvilluan reportazhe të ndryshme për të promovuar bukuritë dhe potencialin turistik të Komunës së Deçanit.
- **Promovimi i Via Ferrata-s:** Një aktivitet i veçantë u zhvillua gjatë muajit Korrik për të promovuar Via Ferrata, me pjesëmarrje falas për tërheqjen e vizitorëve.
- **Marrëveshja me Fondin për Zhvillim Komunitar - CDF:** U nënshkrua marrëveshje për shtimin e një shtegu të ri në fshatin historik Belle, i cili synon të promovojë trashëgiminë kulturore të një prej vendbanimeve më të vjetra në Kosovë.
- **Hiking për promovimin e bjeshkëve:** Organizimi i aktiviteteve të hiking për të eksploruar dhe promovuar bukuritë natyrore të bjeshkëve, duke përfshirë një ecje drejt Liqenit i Tropojës.
- **Organizimi i Aktiviteteve Turistike:** U ndërmorën aktivitete të ndryshme si organizimi i shtëpisë bjeshkatore Alpine "Shkëlzen Haradinaj", kajakimi në Liqenin e Dukagjinit, dhe kamping në grykën e Deçanit.
- **Pjesëmarrja në Sesione Informuese dhe Punëtori:** U organizuan dhe ishim pjesë në sesione dhe punëtori të ndryshme për të diskutuar mbi projekt-ide për investime kapitale, bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- **Takime me Zëvendësministrin e Zhvillimit Rajonal:** Diskutime me zv. Ministrin e Zhvillimit Rajonal për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit në projekte të financuara nga ministria.
- **Hiking në Bjeshkën e Strelcit:** Organizimi i aktiviteteve të hiking për të eksploruar dhe promovuar vende të bukura në Bjeshkën e Strelcit.
- **Promovimi i Via Ferrata-s:** Organizimi i ngjitjes në Via Ferrata pa pagesë si një mënyrë për të promovuar këtë atraksion turistik, veçanërisht gjatë muajit Shtator.
- **Aktivitet me studentët nga Zvicra:** Organizimi i një vizite në Kullat e Drenocit me një grup studentësh nga Zvicra, duke theksuar vlerat kulturore dhe historike të kësaj zone.
- **Hiking në Bjeshkën e Belegut:** Organizimi i një aktiviteti hiking nga Bjeshka e Belegut drejt Majës së Gjeravicës, një prej majave më të larta në rajon.

- **Promovimi i bujtinave:** Një kampanjë për të promovuar bujtinat përgjatë bjeshkëve të Deçanit, duke përfshirë Bujtinën Roshkodoli në Bjeshkën e Roshkodolit.
- **Promovimi dhe bashkëpunimi në turizëm:** Takime me përfaqësues nga klube dhe organizata të ndryshme, si Klubi Alpin Prishtina dhe TV T7, për të diskutuar mbi bashkëpunimin dhe promovimin e turizmit në zonë.
- **Trajnimet për Ekipin e Kërkim-Shpëtimit:** Vazhdimi i trajnimeve për ekipin e kërkim-shpëtimit në komunë, përfshirë bashkëpunimin me FSK-në dhe CAI.
- **Trajnimi i Ekipit të Kërkim-Shpëtimit Malor:** Në kuadër të projektit NaturKosovo, ekipi i Kërkim - Shpëtimit Malor të Komunës së Deçanit ka marrë pjesë në një trajnim të udhëhequr nga ekipi Nacional për Kërkim Shpëtim nga Italia për katër ditë radhazi, duke rritur aftësitë dhe përgatitjen për situata emergjente.
- **Promovimi i kalërimit:** Organizimi i aktiviteteve në ferma të kuajve në Strellc të Poshtëm, si pjesë e nismës për të promovuar hipizmin në ofertën turistike të komunës.
- **Organizimi i Hikingut me Klubin Alpin Gjilani:** Ngjitja e Majës së Marjashit, e cila u realizua në bashkëpunim me Klubin Alpin Gjilani, duke theksuar bukuritë natyrore të rajonit.
- **Promovimi i Bjeshkëve me ATV dhe TV T7:** Organizimi i një aktiviteti bashkë me grupin e ATV 4x4 dhe televizionin T7 për të promovuar bjeshkët e komunës.
- **Bashkëpunimi me Federatën e Golfit të Kosovës:** Takimi me Drejtorin e Federatës, z. Lavdim Zylfiu, për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit dhe zhvillimit të sportit të golfit në Deçan.
- **Koncerti në Përkrahje të Robin Haxhi Krasniqi:** Organizimi i një koncerti me artistë të njohur nga estrada e Kosovës në përkrahje të bokserit të njohur.
- **Bashkëpunimi me OJQ United for Clean Air:** Aktiviteti i mbjelljes së fidaneve pranë lumit Lumbardhi i Deçanit, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.
- **Trajnim për biznese të reja "STARTUP":** Organizimi i trajnimeve për avancimin e njohurive financiare për bizneset e reja, në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) dhe mbështetjen e Bankës Botërore përmes projektit "Fuqizimi i Sektorit Financiar".
- **Bashkëpunimi me përfaqësues italian për projektin NaturKosovo:** Takimi dhe diskutimi për zgjerimin e shtegut të Via Dinarica në Bjeshkën e Madhe, duke u përqendruar në zhvillimin e turizmit malor dhe aventuror.
- **Organizimi dhe rregullimi i Shtegut të Via Dinarica:** Përkushtimi në markimin dhe rregullimin e shtegut të Via Dinarica, një iniciativë për të rritur aksesin dhe tërheqjen e turistëve në zonat malore.

- **Punëtorja në Zyrën e Turizmit Visit Deçani:** Organizimi i një punëtorie me temën e Via Dinarica, duke synuar të rrisë ndërgjegjësimin dhe angazhimin në zhvillimin e turizmit malor.
- **Promovimi i shtigjeve të çiklizmit:** Fokusimi në promovimin e katër shtigjeve të çiklizmit në zonën rurale, të lidhura me zonën urbane, për të promovuar trashëgiminë kulturore të Komunës së Deçanit.
- **Vizita në Komunën e Beranes dhe Bashkëpunimi Rajonal:** Pjesëmarrja në një vizitë në Komunën e Beranes, e cila vazhdoi në Plavë dhe Guci, dhe më pas në Komunën e Andrijevicës, me qëllim të bashkëpunimit në fondet Europiane.
- **Pjesëmarrja në Forum për Zhvillimin Rajonal:** Diskutimi i mundësive të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për zhvillimin ekonomik dhe turistik.
- **Projektimi i Atraksionit Turistik ZipLine Deçani:** Angazhimi në projektimin e atraksionit turistik ZipLine në Deçan, një shtesë e re dhe emocionuese për ofertën turistike të zonës.
- **Organizimi i Kampusit Dimëror:** Pjesëmarrja në organizimin e kampusit dimëror në zonën e turizmit të Deçanit, duke promovuar resurset turistike të rajonit.
- **Kontributi në Punëtorinë e AZHR-Perëndimi:** Pjesëmarrje dhe kontribut në punëtorinë e organizuar nga Agjencia për Zhvillim Rajonal të Perëndimit për zhvillim ekonomik dhe turizëm të qëndrueshëm.
- **Krijimi i kodeve për Menaxhimin e të Hyrave nga Turizmi:** Përpjekje për të adresuar dhe menaxhuar në mënyrë të mirëfilltë të hyrat që rrjedhin nga produktet e turizmit.
- **Sesion Informues për Investime Kapitale:** Pjesëmarrje në sesionin informues dhe punëtorinë lidhur me thirrjen për projekt-ide për investime kapitale në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal PZHR 2025.
- **Pjesëmarrje në Punëtorinë e Let's Do It Peja:** Kontribut në finalizimin e Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit për komunën e Deçanit.
- **Pjesëmarrja në Konferencën e Oda e Hotelarisë dhe Turizmit të Kosovës:** Pjesëmarrje në tryezën e organizuar për shënimin e Ditës Botërore të Turizmit.
- **Bashkëpunimi me Zyrën e Regjistrimit të Punëkërkuesve:** Takime me zyrën e regjistrimit të punëkërkuesve në ZP-Deçan për të krijuar një bashkëpunim të frytshëm.
- **Pjesëmarrje në Punëtorinë për Ligjin e Pronës:** Angazhim në punëtorinë lidhur me projektligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së luajtshme të komunës.
- **Takim i Komunave të Rajonit Perëndimorë me MZHR:** Pjesëmarrje në takimet rajonale me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal për të diskutuar zhvillimin e përbashkët.

- **Pjesëmarrja në Punëtorinë e Swisscontact-PPSE:** Kontribut në punëtorinë për hartimin dhe përditësimin e Strategjive Komunale të Turizmit, nën organizimin e Swisscontact-PPSE.
- **Pjesëmarrje në punëtorinë për fuqizimin e dialogut** ndërmjet institucioneve dhe bizneseve, organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në bashkëpunim me Departamentin e Industrisë.
- Pjesëmarrje në trajnim nga projekti DEMOS, dedikuar anëtarëve të grupeve punuese për planifikimin dhe dokumentimin e dëgjimeve buxhetore, me fokus në përfshirjen e komunitetit dhe transparencën buxhetore.
- Pjesëmarrje në aktivitetin ndërkufitar **“Tri-Border – Një ditë, një majë, skiatorë nga tre vende”**.
- Pjesëmarrje në konferencën për publikimin e analizës mbi “Planifikimin Strategjik, Zhvillimin e Projekteve dhe Menaxhimin e Kontratave”, organizuar nga KLGI dhe projekti **DEMOS**
- Pjesëmarrje në **Panairin e Ekonomisë Qarkore – RE-KO 25**, i pari i këtij lloji në Kosovë, mbajtur më 12 prill 2025 në Prishtina Mall, FLORI Gallery.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës me temën **“Turizmi në Fokus”** – Njohuri Bazë dhe Kuadri Ligjor për Komunitat
- Pjesëmarrje në edicionin **e 25-të të Panairit AGROKOS & Agroturizëm**, i zhvilluar më 27–28 maj 2025 në Prishtinë.
- Pjesëmarrje në Konferencën “Roli i Universiteteve në Zhvillimin Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar”, organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.
- Pjesëmarrje në Konferencën për Investitorë, të organizuar në kuadër të projektit PPSE nga **Swisscontact** dhe Instituti Riinvest, me mbështetje nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).
- Pjesëmarrje në aktivitetin për shënimin e Ditës Botërore të Mjedisit – 5 Qershori, organizuar nga **CNVP** dhe i mbështetur nga SIDA, me temën “Ta luftojmë ndotjen nga plastika”.
- Pjesëmarrje në **Konferencën për Zhvillimin e Turizmit në Kosovë**, organizuar nga **Swisscontact (PPSE)** dhe Instituti Riinvest, me theks në arritjet, sfidat dhe mundësitë për sektorin.
- Pjesëmarrje në takimin e **Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik të Asociacionit të Komunave të Kosovës**, ku u diskutuan sfidat kryesore të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik dhe partneritetit publiko-privat.

- Pjesëmarres ne organizimin e **Asociacioni i Komunave të Kosovës** si pjesë në takimin e radhës të Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik, ku do të diskutojmë sfidat kryesore të komunave në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, të përmbledhura në raportin "Sfidat e Komunave ne Fushën e Zhvillimit Ekonomik Lokal si dhe Partneritetit Publiko-Privat".
- Aktivitet i organizuar në Bjeshkën e Belegut! Falënderime televizionit T7 për promovimin dhe mbështetjes së vazhdueshme në shfaqjen e bukurive nga qyteti i Deçanit.
- Komuna e Deçanit renditet e para në Kosovë në Barometrin Turistik - Universiteti "Haxhi Zeka", në bashkëpunim me kompaninë Terra, ka prezantuar **Barometrin Turistik**, platformën e parë në Kosovë që ofron një pasqyrë të detajuar mbi sektorin e turizmit, bazuar në vlerësimet dhe komentet e vizitorëve
- Gjatë dy ditëve në komunën e **Ulqinit**, patëm 5 takime zyrtare me krytarin, kabinetin, agjencionin e turizmit si dhe perfaqeues nga organizatat turistike.
- Gjatë këtyre tri ditëve Via Dinarica Kosovo në Milano - Komuna e Deçanit – Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, përmes sektorit të saj të turizmit (Visit Deçan), është duke prezantuar me krenari shtegun e Via Dinarica në Panairin e Milanos - "**Fa' la cosa giusta**", duke promovuar bukuritë unike natyrore dhe mundësitë e turizmit aventurier të rajonit të Deçanit.
- Takim me kryetarin e Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj, së bashku me Këshillin Organizativ për Garën e Skijimit "Kupa e Gjeravicës", mbajtën takimin e radhës, në të cilin u diskutuan detyrat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar.
- Komuna e Deçanit, në bashkëpunim me Federatën e Skitarisë së Kosovës, organizuan me sukses garën e skijimit "**Kupa e Gjeravicës**", e cila u mbajt me karakter promovues, për të nxjerrë në pah resurset natyrore të kësaj zone të mrekullueshme.
- Pjesëmarres në **Panairin e 21-të të Turizmit dhe Sportit – Prishtinë**, 15-16 - Visit Deçani
- Takim me përfaqësues nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar – **JICA** dhe nga **Departamenti i Turizmit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**.
- Takim i rregullt nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj, u mbajt takimi i parë i Këshillit Organizativ për edicionin e 14-të të Panairit Veror – një ngjarje tradicionale që ka marrë përmasa të rëndësishme rajonale.

- Takim i rregullt me KFOR-in Italian
- Aktivitet i organizua nga Sh.M.T "Tafil Kasumaj" në Deçan, me iniciativën e prof. Mataj dhe pjesëmarrjen e nxënësve të kësaj shkolle, ndërsa u mbështet me pajisje dhe biçikleta nga Visit Deçani.
- Bashkontribues ne dokumentin e **Strategjisë së Zhvillimit Lokal 2024-2029** – një dokument me rëndësi të veçantë për Komunën e Deçanit, që përmban informata të vlefshme dhe një punë që duhet të vlerësohet nga të gjithë.
- Fitues te projektit per ndërtimin e 8 urave lidhëse në zonën malore të Deçanit – një investim i përbashkët i propozuar për bashkëfinancim me MZHR, që synon të përmirësojë infrastrukturën dhe të lehtësojë qasjen për komunitetin lokal dhe për turistët që vizitojnë Deçanin.
- Organizatore, në bashkëpunim me organizatën "ShB Mariashi", të garës **"Deçani X Race"** – një aventurë unike për rajonin e Dukagjinit dhe për gjithë Kosovën! Gara e veçantë sjell shumë adrenalinë, natyrë të mrekullueshme dhe sfida emocionuese për të gjithë pjesëmarrësit.
- Më datë 05.06.2025, në ambientet e stacionit të ShKShMK-së në Deçan, u pritën për një vizitë falënderuese dhe informuese Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, z. Jörn Rohde, Konsulli i ShBA-ve, z. Seth Emerson, si dhe z. Martijn Huijbers, Menaxher Operacional në Ambasadën e Mbretërisë së Holandes, së bashku me përfaqësues të tjerë diplomatik nga ambasadat.
- Pjesëmarrës në dy ditë, në Gothenburg të Suedisë, është mbajtur **Karnevali Tradicional**, ku shtete të ndryshme të botës paraqesin traditat, produktet dhe kulturën e tyre.
- Aktiviteti i çiklizëmit - **"Shijo çiklizmin, përjeto bukurinë e Liqenit të Dukagjinit"** – 35 çikliste
- **Takim me gratë në bujqësi dhe zhvillim ekonomik** - Zyra për Barazi Gjinore, në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Deçanit, në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, organizoi një takim tematik me titull: "Gratë në bujqësi dhe zhvillim ekonomik".
- Në kuadër të aktiviteteve të Panairit Veror 2025, sot në Deçan u organizua **promovimi i librit "Panairi Veror 2012–2024"** nga autori Sutki Hulaj – një rrëfim i ndjerë që pasqyron me përkushtim vitet e punës, kulturës dhe emocioneve që ky panair ka sjellë ndër vite në jetën e qytetit tonë.
- Panairi Veror 2025 – Një atmosferë unike në zemër të Deçanit!
- Organizimi I Panarit Edicioni I 14-të – 45 biznese

➤ **Zhvillimi dhe Promovimi i Turizmit në Komunën e Deçanit**

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2025, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Deçanit ka angazhuar intensivisht resurset dhe energjitë e saj në promovimin dhe zhvillimin e turizmit në rajon. Përmes një serie aktiviteteve të ndryshme dhe të koordinuara, Drejtoria ka synuar të nxisë një turizëm të qëndrueshëm dhe tërheqës që shtrihet nga turizmi malor dhe aventura deri te promovimi i trashëgimisë kulturore. Aktivitetet përfshijnë:

- **Rregullimi i hapësirave të Qendrës Informuese Turistike:** Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës së qendrës turistike për të ofruar informacion më të mirë dhe shërbime për vizitorët.
- **Lansimi i Web-Faqes së Turizmit:** Zhvillimi dhe lansimi i një faqe interneti dedikuar turizmit në Deçan, që ofron informacion të detajuar dhe të përditësuar për turistët.
- **Përgatitja dhe shpërndarja e Fletushkave:** Krijimi dhe distribuimi i materialeve informative për bjeshkët, duke ofruar informacione të detajuara dhe tërheqëse për turistët.
- **Shtigjet e shënjëzuara për ecje/hiking:** Përfshirja dhe shënjëzimi i shtigjeve të ndryshme malore si Bjeshkën e Roshkodolit, Bjeshkën e Prilepit, dhe të tjera, duke u bërë këto zona më të qasshme dhe tërheqëse për turistët.
- **Promovimi i bukurive natyrore dhe burimeve turistike:** Realizimi i katër video klipave për të nxjerrë në pah bukuritë dhe resurset natyrore të zonave rurale dhe malore të Deçanit.
- **Programi Ndërkufitar me Malin e Zi:** Angazhimi në një program ndërkufitar me Malin e Zi, duke theksuar bashkëpunimin rajonal në fushën e turizmit.

- **Bashkëpunimi me organizata të ndryshme:** Bashkëpunimi me organizata si SWISS CONTACT, USAID, CDF, ADF, ECO, Bashkimi Evropian, dhe GIZI për të forcuar dhe zgjeruar fushën e turizmit në Deçan.
- **Krijimi i Ekipit të Kërkim - Shpëtimit:** Formimi i një ekipi të dedikuar të Kërkim-Shpëtimit në Komunën e Deçanit, i cili do të kontribuojë në sigurinë e turistëve dhe banorëve lokalë.
- **Vendosja në hartë e shtigjeve të çiklizmit urban:** Shënjëzimi dhe përmirësimi i shtigjeve të çiklizmit në zonën urbane të Deçanit, duke e bërë qytetin më tërheqës për turistë dhe banorët lokal.
- **Aktivitetet e ngjitjes malore:** Organizimi i aktiviteteve të ngjitjes malore si "Ngjitja në Bellen e Balajve" dhe "Ngjitja në Bjeshkën e Madhe", si dhe ngjitja në Via Ferrata gjatë Ditës së Çlirimit të Deçanit, duke promovuar këtë atraksion të njohur.
- **Koncerti në qendër të qytetit:** Organizimi i një koncerti madhështor në qendër të qytetit si pjesë e aktiviteteve të Panairit Veror.
- **Panairi Tradicional Veror:** Organizimi i panairit me pjesëmarrjen e 43 bizneseve dhe kompanive nga qytetet e Kosovës dhe shteteve fqinje, duke ofruar një platformë për promovimin e bizneseve lokale dhe ndërkombëtare.
- **Trajnimi për rrjete sociale nga NaturKosovo:** Pjesëmarrja në trajnime për përdorimin e rrjeteve sociale, me qëllim përmirësimin e promovimit dhe marketingut të turizmit në rrjete sociale.
- **Vizita studimore në Itali:** Pjesëmarrja në një vizitë studimore në Itali në kuadër të NaturKosovo, duke u takuar me përfaqësues dhe akterë të turizmit Italian dhe mësuar nga praktikat e tyre.
- **Pjesëmarrja në shenjëzimin e shtigjeve:** Angazhimi në shenjëzimin dhe përmirësimin e shtigjeve në bjeshkët e Deçanit, duke përmirësuar infrastrukturën për ecje dhe hiking.
- **Pastrimi dhe shenjëzimi i Via Ferrata:** Përkushtimi në pastrimin dhe mirëmbajtjen e Via Ferrata, një nga atraksionet kryesore turistike të rajonit.
- **Fizibiliteti i shtigjeve të Via Dinarica:** Studimi dhe zgjerimi i shtigjeve ekzistuese në kuadër të shtegut Via Dinarica, duke e bërë atë më tërheqës për turistët.
- **Trajnimi i Kërkim Shpëtimit Malor:** Pjesëmarrja në trajnimet e specializuara për Kërkim-Shpëtim Malor, duke rritur kapacitetet e reagimit në situata emergjente.
- **Organizmi i Takimit për projektin NaturKosovo:** Organizimi i takimeve për prezantimin e mundësive të granteve në kuadër të projektit NaturKosovo, duke nxitur përfshirjen e bizneseve, fermerëve dhe shoqatave në turizëm.
- **Organizimi i trajnimeve për aplikimin në grantet e projektit NaturKosovo:** Mbajtja dhe promovimi i biodiversitetit përmes trajnimeve për aplikimin në grantet e ofruara nga ky projekt.

- **Takim me përfaqësues nga Shoqata e Kayakit – Deçani:** Organizimi i aktiviteteve me kayak në Liqenin e Radoniqit, duke ofruar një eksperiencë të veçantë për turistët dhe banorët lokal.
- **Trajnimi nga Utalaya për Digital Marketing:** Përqëndrimi në rritjen e aftësive digjitale të bizneseve dhe individëve lokal për të promovuar turizmin në Deçan.
- **Bashkëpunimi dhe vizita me Bashkitë e Lezhës dhe Ulqinit:** Nxitja e bashkëpunimit rajonal për të promovuar turizmin dhe kulturën ndërshtetërore.
- **Bashkëpunimi dhe vizita në Qytetin e Tetovës:** Zgjerimi i bashkëpunimit për promovimin e turizmit rajonal.
- **Emisione në TV për promovimin e turizmit:** Përdorimi i mediave për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesin për turizmin në Deçan.
- **Aktiviteti me Utalaya - prezantimi në shkollë:** Ngritja e ndërgjegjësimit mbi biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore të Deçanit nëpërmjet aktiviteteve informative në shkollë.
- **Pjesëmarrja në Panairin e Turizmit dhe Sportit në Prishtinë:** Prezantimi i ofertave turistike dhe sportive të Deçanit në një skenë më të gjerë.
- **Takim me përfaqësues nga Agjencia Italiane e Turizmit:** Diskutimi i mundësive të bashkëpunimit në kuadër të projektit NaturKosovo.
- **Pjesëmarrja në Organizmin e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale:** Angazhimi në aktivitete që promovojnë decentralizimin dhe zhvillimin lokal.
- **Takim me Organizatën 'Celim' nga Italia:** Diskutimi i fazave të vazhdueshme të projektit NaturKosovo.
- **Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga CHWB:** Promovimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes për Brendin Rajonal të Trashëgimisë Kulturore.
- **Pjesëmarrës në Organizimin e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI):** Mbështetja e iniciativave për përfshirjen e grave në zhvillimin ekonomik dhe social.
- **Vizita në fshatrat turistik Belle dhe Pleqe:** Promovimi i turizmit dhe kulturës në këto fshatra.
- **Bashkëpunimi me OJQ 'Shkelzen Haradinaj':** Zhvillimi i projektit "Tourism hubs for better offer in less advantaged mountainous areas", duke theksuar rëndësinë e turizmit në zonat malore.
- **Promovimi i trashëgimisë kulturore:** Fokusi në promovimin e Kullave të Drenocit si një pikë turistike e rëndësishme.
- **Emision për të promovuar Kayak:** Nxitja e sporteve ujore dhe aventurat në natyrë nëpërmjet transmetimeve televizive.

Aktivitete të Veçanta të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në vitin 2025

1. Revista Travel Magazine

- Përmbajtja: Revista promovoi Komunën e Deçanit dhe resurset e saj natyrore dhe kulturore në një artikull me 8 faqe, duke nxjerrë në pah atraksionet dhe potencialin turistik të zonës.
- 2. **Aktivitet në Bjeshkën e Belegut**
 - Përmbajtja: Në kuadër të një kampanje promovuese, u organizua një aktivitet për të promovuar pistën e skijimit dhe për të theksuar rëndësinë e investimeve për zhvillimin e sporteve të bardha në këtë zonë.
- 3. **Trajnimi i ekipit të kërkim shpëtimit malor**
 - Përmbajtja: Në kuadër të projektit NaturKosovo, u mbajt një trajnim dimëror për ekipin e kërkim shpëtimit malor, me qëllim rritjen e aftësive dhe përgatitjen e tyre për situata emergjente.
- 4. **Marrëveshja me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal**
 - Përmbajtja: Komuna e Deçanit lidhë një marrëveshje me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal për zhvillimin e produkteve turistike në fshatin alpin, duke përfshirë ZipLine dhe Ranch për kuaj.
- 5. **Marrëveshja e bashkëpunimit mes 5 komunave të 3 shteteve fqinjë**
 - Përmbajtja: Kjo marrëveshje synon zhvillimin e turizmit në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërkomunal për nxitjen e turizmit.
- 6. **Thirrje për trajnime dhe certifikim në Via Ferrata**
 - Përmbajtja: Komuna e Deçanit dhe ekipi i zyrës së turizmit Visit Deçani organizuan thirrjen për trajnime dhe certifikim të stafit në Via Ferrata për të siguruar standarde të larta të sigurisë në atraksionet turistike.
- 7. **Pjesëmarrje në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit 2025**
 - Përmbajtja: Komuna e Deçanit mori pjesë për dy ditë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit, duke promovuar destinacionet dhe ofertat turistike lokale.
- 8. **Aktivitet me biçikleta**
 - Përmbajtja: U organizua një aktivitet me biçikleta për të promovuar "Shtegun e gurtë" në Komunën e Deçanit, duke inkurajuar turizmin aktiv dhe avanturier.
- 9. **Përrurimi i Stacionit të Kërkim-Shpëtimit Malor**
 - Përmbajtja: U përrurua stacioni i Kërkim-Shpëtimit Malor në qytetin e Deçanit, duke përmirësuar kapacitetet për përgjigjen ndaj emergjencave malore.
- 10. **Takim me akterët e turizmit**
 - Përmbajtja: U zhvillua një takim me akterët e turizmit nga qyteti i Deçanit për të diskutuar sfidat, arritjet dhe objektivat që janë përpara për zhvillimin e turizmit lokal.
- 11. **Aktivitete të vazhdueshme në Via Dinarica**
 - Përmbajtja: Gjatë muajve Prill, Maj dhe Qershor, u zhvilluan aktivitete për hapjen, markimin, vendosjen në GPS dhe shenjëzimin e shtegut të Via Dinarica duke bërë lidjen e Bjeshkës së Madhe me shtegun ekzistues.

12. Takime me investitorë

- Përmbajtja: Gjatë muajve Maj dhe Qershor u mbajtën 4 takime me grupe të ndryshme investitorësh të cilët shprehën entuziazëm për mundësitë e investimeve në bjeshkët e Deçanit.

13. Takim me përfaqësues italian

- Përmbajtja: U zhvillua një takim me përfaqësues italian në kuadër të projektit NaturKosovo për planifikimin dhe vazhdimësinë e objektivave të ardhshme.

14. Aktivitet në Liqenin e Dukagjinit

- Përmbajtja: U organizua një aktivitet me kajak në Liqenin e Dukagjinit për të promovuar sportet ujore në Deçan, në bashkëpunim me Klubin e Kajakit Aqua nga Deçani.

15. Organizimi i Panairit Veror

- Përmbajtja: U mbajtën 5 takime përgatitore për organizimin e Panairit Veror dhe aktivitetet që përfshin agjenda e tij për vitin 2025.

16. Panairi Veror Tradicional EXPOS Deçani 2025

- Përmbajtja: Një nga eventet më të mëdha të organizuara nga komuna, ky panair ofroi aktivitete të ndryshme për dy ditë duke promovuar produktet dhe atraksionet lokale.

17. Koncert i madh me yjet e estradës

- Përmbajtja: U organizua një koncert madhështor me yjet e estradës në qendër të qytetit, për të tërhequr turistë dhe për të festuar sukseset e komunitetit.

18. Aktivitet në bjeshkën e Strellcit

- Përmbajtja: U organizua një aktivitet promovues me një drekë tradicionale në bjeshkën e Strellcit për të promovuar turizmin në zonën alpine.

Përmbyllje

2025: Viti i rritjes dhe inovacionit për Deçanin

Ndërsa vitit 2025 ka përfunduar, është e rëndësishme të reflektojmë mbi arritjet dhe sfidat që Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Deçanit ka përjetuar dhe mposhtur. Ky vit ka qenë një periudhë transformuese për Deçanin, ku përpjekjet tona kolektive në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit kanë sjellë rezultate të dukshme dhe të prekshme.

Me një qasje të përqëndruar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovacionin, ne kemi arritur të promovojmë një model të turizmit dhe zhvillimit ekonomik që jo vetëm që nxitë rritjen ekonomike, por gjithashtu respekton dhe ruajtjen e mjedisit dhe trashëgiminë kulturore. Nga organizimi i aktiviteteve turistike të reja dhe bashkëpunimet rajonale dhe ndërkombëtare, deri te nxitja e ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi biodiversitetin dhe kulturën, vitin 2025 e kemi bërë një vit të veçantë për komunën tonë.

Projektet dhe iniciativat e këtij viti, si NaturKosovo dhe zgjerimi i ofertave turistike malore, kanë vendosur themelin për një të ardhme më të ndritur dhe më të qëndrueshme për Deçanin. Kemi dëshmuar se, përmes bashkëpunimit të fortë dhe përkushtimit të përbashkët, mund të krijojmë një mjedis më të mirë për banorët tanë dhe vizitorët e ardhshëm.

Duke u përgatitur për vitin 2026, ne jemi të vendosur të vazhdojmë këtë rrugë të suksesit, duke u përqëndruar në zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës, promovimin e inovacioneve në fushën e biznesit dhe turizmit, dhe zgjerimin e bashkëpunimeve tona për të krijuar një Deçan edhe më të fortë dhe më tërheqës.

Falënderojmë të gjithë partnerët, organizatat dhe individët që kanë kontribuar në këto arritje. Ju ftojmë të vazhdoni të jeni pjesë e rrugëtimit tonë drejt një të ardhmeje më të ndritur dhe të qëndrueshme për Komunën e Deçanit.

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, Komuna e Deçanit

Me respekt,

Drejtori për Zhvillim Ekonomik

Isuf Demhasaj

